

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Rroba pune”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

18114000-1

18235400-9

18331000-8

18800000-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

2 022 500(dy milion e njëzetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa Tvsh Monedha, pa TVSH.

Bazuar në nenin 76 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” e ndryshuar, në zbatim të urdhërit të titullarit, për ngritjen e komisionit për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës për procedurën e prokurimit komisoni pasi u njoh me objektin e prokurimit, bazuar në VKM 285 datë 19.05.2021 neni 76, ka bërë përllogaritjen e vlerës limit të kontratës sipas mesatares së ofertave të testimit të tregut.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoritet kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk duhet të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të të kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë e arrijnë vlerën në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023,2024) nga autoritetet përkatëse tatimore.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2025, nga organet e qeverisjes vendore për pikat ku ushtrohet aktiviteti sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklarates për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontrata të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga shpallja e njoftimit të kontrates, në një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontrates që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit bga data be shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 Për Prokurimin Publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit. Përvoja e mëparshme është një element i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik, për të vërtetuar se mallrat objekt prokurimi plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesi certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë si më poshtë:

- ISO 9001:2015 "Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë" (e vlefshme) ose ekuivalente;
- ISO 14001:2015 "Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit" (e vlefshme) ose ekuivalente;
- ISO 45001:2018 ose të përditësuar ISO 45001:2023 "Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë" (e vlefshme) ose ekuivalente.

Argumentimi: Bazuar në Ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimet Publike", I ntryshuar

Neni 52 - Kriteret e kualifikimit: I cili I jep mundësinë autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret kualifikimi që lidhen me aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë. Certifikatat ISO, si dëshmi i sistemeve të menaxhimit, bëjnë pjesë në këtë kategori.

Pika 1 (c) e Nenit 52: Aftësia teknike dhe profesionale përfshin aftësinë për të zbatuar standardet e menaxhimit të cilësisë.

Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave si certifikatat ISO e cila është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar suksesin e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklarate/certificate konformiteti produkti për artikujt:

- Pelerine shiu SSH/EN 343:2019 klasi 3.
- Kepuce pune SSH/EN ISO 20345:2011.
- Jelek fosforeshent sipas standartit SSH/EN ISO 20471:2013 klasi 2.
- Xhakete sipas standartit SSH/EN ISO 20471:2013 klasi 2.
- Kominoshe sipas standartit SSH/EN ISO 20471:2013 klasi 2.

Të vlefshme ose ekuivalente, në mënyrë që të vërtetohet përputhshmëria me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimet Publike", I ndryshuar.

Specifikimet Teknike: Ky nen parashikon që specifikimet teknike duhet të përcaktojnë karakteristikat e kërkuara të punëve, mallrave ose shërbimeve. I jep mundësinë autoritetit kontraktor të referohet te standardet europiane (EN), vlerësimet teknike europiane, specifikimet teknike të përbashkëta, standardet ndërkombëtare (ISO), standardet kombëtare (SSH) ose dokumentet e tjera normative. Certifikatat e konformitetit shërbejnë si dëshmi se këto specifikime teknike janë plotësuar.

Kriteret e Kualifikimit: Ky nen përcakton "aftësinë teknike dhe profesionale" si një kriter kualifikimi. Pika 1(c) parashikon: "Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë certifikata të lëshuara nga institute ose agjenci zyrtare të njohura të kontrollit të cilësisë ose nga agjensi të njohura kompetente në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë ose të mjedisit." Certifikatat e konformitetit bëjnë pjesë në këtë kategori, pasi ato janë dëshmi të një kontrolli të cilësisë apo përputhshmërisë me standarde specifike.

Prova e Përputhshmërisë: Ky nen thekson se operatori ekonomik duhet të sigurojë prova që mallrat objekt prokurimi i përgjigjen specifikimeve teknike. Këtu përfshihen certifikatat e konformitetit të lëshuara nga organizma të pavarur.

Kërkesa për certifikata konformiteti si kriter kualifikues është e domosdoshme për autoritetin kontraktor. Ajo siguron cilësi, siguri dhe përgjegjshmëri, duke minimizuar rreziqet teknike, financiare dhe ligjore.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Raport Testimi (fletë-analizë) për artikullin: “*Xhakete*”, “*Përparëse pune*”, “*Kominoshe*” dhe “*Pelerinë shiu*”, të lëshuar nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).

Argumentimi: Vendosja e raporteve të testimit (fletë analizash) si kriter kualifikues në është një kërkesë e cila siguron që mallrat e ofruara plotësojnë në mënyrë objektive standardet e cilësisë, sigurisë dhe performancës të parashikuara nga kërkesat e autoritetit kontraktor.

Raporti i testimit, ose fletë e analiza, janë dokumente zyrtare të lëshuara nga laboratorë të akredituar ose të njohur, të cilat dëshmojnë se një produkt, material ka kaluar teste specifike dhe ka plotësuar parametrat që kërkohen.

Raporti i testimit ofron të dhëna konkrete dhe të matshme mbi karakteristikat specifike të produktit. Kërkimi i raporteve të testimit minimizon rrezikun e marrjes së produkteve që nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara, duke parandaluar kështu kostot shtesë duke shmangur vlerësimet subjektive.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë skeda teknike/katalog për artikujt me nr rendor 1-14, të cilat duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.

Katalogët dhe skedat teknike janë një e dhënë e rëndësishme, pasi me anë të tyre autoriteti kontraktor vërteton origjinën e mallrave që prokurohen dhe garanton cilësinë e tyre.

2.3.6 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për mallrat objekt prokurimi për të gjithë llojet e artikujve (sipas tabelës të përcaktuar në shtojcën 7 të DST).

- Mostrat të jenë të shoqëruara shkresë, listë inventarizimi dhe të identifikuara sipas numrit rendor të përcaktuar në shtojcën 7 të DST, firmosur dhe vulosur nga O.E ofertues.

Mostrat duhet të kenë të ngjitur etiketë e cila të përmbajë: “Emërtimin i mallit”, numrin sipas shtojcës 7 në DST, emrin e O.E ofertues, datën dhe orën e zhvillimit të tenderit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të paraqitura për të vërtetuar përputhshmërinë me specifikimet të kërkuara dhe të kryej analizat e nevojshme laboratorike, nëse do shihet e arsyeshme.

- Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin përkatës nga ofertuesi për paraqitjen e mostrave në emër dhe për llogari të tij.

Mostrat do të dorëzohen pranë AK në ditën dhe orën e parashikuar për hapjen e ofertave.

Shënim: Mosparaqitja e mostrave përbën kusht skualifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar, në [Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#) dhe nenit 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejt me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Paraqitja e mostrave nga OE, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryeje verifikimet (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik me qëllim vertetimin e përputhshmërisë me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIME TEKNIKE

1. Xhakete

Materiali të jetë 65% polyester dhe 35% pambuk, pesha 240-280 gr/m², cilësi e lartë. Xhaketa ka dy xhepa të pjerrët me fileto në pjesën e poshtme dhe dy xhepa pllakë në pjesën sipër. Mbyllja e xhaketës do të jetë me zinxhir i cili mbulohet nga një copë mostër dhe me percina/velkrof. Xhaketa do të jetë me mëngë të gjata, të cilat të jenë të pajisura me manshetë të mëngët dhe në pjesën fundore. Xhaketa në gjithë perimetrin e gjoksit dhe mbrapa dhe te menget ne te njejtin nivel duhet të jetë e pajisur me shirit fosforeshent 5 cm të gjere i segmentuar me nderprerje me ngjitje. Gjatësia e xhaketës do të jetë sipas standarteve të xhaketave të kostumeve klasike dhe jo më e shkurtër. Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 40°C. Logo do të jetë sipas modelit bashkëlidhur. Ngjyra e negociueshme midis blu e errët/gri e errët/jeshile. Te jete sipas standartit SSH/EN ISO 20471.

2. Kominoshe

Kominoshet SSH/CE per punëtoret industrial të cilët janë të ekspozuar ndaj mbetjeve të ndryshme.

- -Certifikim sipas standartit SSH /EN ISO 20471
- Rezistentë ndaj flakëve e garantuar për gjithë jetëgjatësinë e pëlhurës;
- Mbrojtje nga nxehtësia rezatuese, konvektive, dhe me kontakt;

- E certifikuar për mbrojtjen nga skorjet e metaleve të shkrira;
- Bel elastik në anësore për komfort maksimal;
- Hapje anësore e lehtë dhe e shpejtë;
- Pëlhura e klasifikuar me UPF 50+ për të bllokuar 98% rrezeve UV;
- 4 xhepa për vendosje të sigurte;
- Pesha: 240 gr/m² (+ - 10 %).
- Percaktimi I dendësisë baze dhe ind B=460 I= 190
- Qëndrueshmëria dhe elasticiteti në keputje sipas bazës dhe indit B=1350 I= 500
- Qëndrueshmëria dhe elasticiteti në grisje sipas bazës dhe indit B=35 I= 22
- Perberja: 67% poliestër dhe 33% pambuk
- Efekti piling pas 1000 cikle Nota 4 (ISO 12945-1)
- Lloji ithurjes : Garniturë
- Stabiliteti dimensional ISO 5077 me pak se 2% në të dy drejtësitë.
- Ngjyra e negociueshme midis blu të errët/gri të errët/jeshile.

3. Mushama shiu

Tekstil i gomuar (mos përshkueshmëria e ujit 100%)

Ngjyra: Jeshile/blu të errët

Masa m²: 180 ± 10 gram

Trashësia: 0.3 ± 0.05mm

Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 30°C: Nota 5

Thurja : Garniturë Përbërja fibrore: 100 Polyester.

4. Këpuce pune

Kepuce te mbrojtjes ne pune, forme atlete me ose pa qafe, me pore steelite S3 me linje speciale ajrosje

sipas standardit SSH EN ISO 20345 S3 Rezistente ndaj vajrave dhe hidrokarbureve. Rezistent ndaj rreshqitjeve. E veshur me material kunder goditjeve 200J teknologjia PU dendesi e dyfishte, antistatike dhe anatomike poliuretani i bute i mbuluar me pelhure absorbuese dhe me ajrosje me 3 shtresa per transferimin e lageshtise ne pjesen e jashtme dhe tharje te shpejte . Perdorimi te jete I hjeshte dhe kamba te ndjehet komode gjate perdorimit duke ruajtur anen shendetsore te perdoruesit. Gjate perdorimit te jete rezistent ndaj djersitjes te mbushura me material per rehati te kockave dhe kyceve te kembes. Mbyllja me lidhese. Lekure bualli ujiduruese.

- ☐ Certifikim SSH/CE
- ☐ Mbrojtjesja e gishtave kompositë për një mbrojtje maksimale
- ☐ Shollë e mesme anti-shpim kompositë me shtresë të butë PU
- ☐ Membranë 100% ujëdaluese
- ☐ Shollë anti-rreshkitje (SRC) për të parandaluar rrëshkitjen në qeramike dhe celik.
- ☐ Shollë rezistente ndaj vajrave
- ☐ Shuall me densitet të dyfishtë
- ☐ Përshtatje e gjerë
- ☐ Peshë e lehtë
- ☐ Rrjete ajrosese 3D
- ☐ Shtrese mbrojtëse TPU te gishtat për rezistencë më të lartë
- ☐ Lekurë e plotë me trashësi 1.8mm
- ☐ Ngjyra/Fit/Size gri e errët/zeze
- ☐ Artikulli duhet të jetë sipas Standarteve SSH/ EN ISO 20345 S3, ose Ekuivalente,

CERTIFIKIMI

- ☐ Etiketa e firmes prodhuese te jete e trapezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese dhe certifikimit, per udhezimin e perdorimit.
- ☐ Te stampuara me logon e institucionit.

5. Çizme peshkatari

Duhet te jene sipas Direktives CE ,per mbrojtjen individuale 89 /686 /EEC dhe permbush standartet evropiane EN ISO 20345 : 2011.

Material sintetik dhe natyral sipas normatives EN ISO 20345 per performance dhe cilesine .

Mbrojtja nga impakti godites deri ne 200 Joules ,Rezistenca ne penetrim (1100 neëtones)

Konduktiviteti rezistenca maximale 100 kΩ Antistatike rezistenca nga 100 kΩ -1000 mΩ .

6. Bluza polo

Bluze verore me tre kopsa, tip polo

100% pambuk

Masa: 180 gr/m²

Thurja: trikotazh

Ngjyra: sipas kerkeses se AK

7. Doreza pune profesionale

Doreza pune per grumbulluesit e mbeturinave me perberje 100% polyester elastic.

poliretan Trashesi 0.6-0.8 mm Qendrueshmeri e ngjyres Nota 4;

Pjesa e jashtme e pellembe se dores dhe e gishterinjve te jete e gomuar, pjesa e brendshme dhe ajo e jashtme beze pambuku. Te kene gjatesi deri te kyçi me gjeresi 6 cm me perberje pambuk i thurur elastik.

☐ Sipas normative; SSH EN 420. SSH /EN 388. 2003 ose ekuivalente, CERTIFIKIMI

☐ Etiketa e firmes prodhuese te jete e trapezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese

dhe çertifikimit,per udhezimin e perdorimit

8. Jelek fosforeshent

Jeleku të jetë me ngjyre te verdhe dhe i përbere nga material 100% Poliester. Pesha: 125 gr/m2. E përshtatshme për punime ne ambjent të jashtem. Me shirit 5 cm fosforeshent në pjesën e përparme dhe në pjesen e pasme. Me rendesi:

Ne pjesen e pasme te kete te shkruar Logon e institucionit,

Te jete sipas standartit SSH/EN ISO 20471.

9. Perparese pune

Materiali të jetë 65% polyestër dhe 35% pambuk. Pesha: 240-280 gr/m2. Të ketë jakë, hapja para dhe mbërthimi me kopsa. Në pjesën e përparme të saj të ketë dy xhepa dopi pllakë dhe sipër një xhep në krahun e majtë. Përparset të jenë me mëngë të gjata dhe me gjatësi të trupit deri afër gjurit. Logo do të jetë sipas modelit bashkëlidhur. Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 40°C. Ngjyra e negociueshme midis blus së errët dhe jeshiles

10. Çizme te shkurtra

Cizmet e shkurtra prodhuar me material PVC ngjyre jeshile jane te padepertueshme nga uji .

Materiali PVC edhe rezistent ndaj ujit po.

Cizme shiu te gjata materiali PVC

Cizmet e gjata prodhohen nga nje material PVC ngjyre jeshile jane te padepertueshme nga uji .

11. Pantallona pune

Materiali të jetë 65% polyester dhe 35% pambuk, pesha 240-280 gr/m2, cilësi e lartë.

Te jene te realizuara nga poli –pambuku cilesor ,ka si vecori 2 xhepa te pjerret perpara ,xhepa anesore per futje veglash ,me shirita fosforeshent ne pjesen e gjurit .

12. Kaske pune sigurie

Kaskat jane per perdorim te pergjithshem, per te ofruar mbrojtje nga renia e objekteve te ndryshme dhe demtime te mundshme te kafkes.

Kaskat duhet te jene te lehta , te forta dhe te rehatshme dhe te krijojne nje mundesi te thjeshte perdorimi.

Konfigurimi i helmetes ne pjesen e jashtme te saj me material ngjites reflektiv krijon mundesine e nje pamje vizuale me te qarte dhe gjate punimit naten.

-Kasketa te jete e adoptueshme per cdo permase(51-63 cm)

-Te mundesoj absorbim ndaj goditjeve dhe te jete rezistente, gjithashtu helmata te jete me ajrosje per qarkullim ajri.

-Deformim lateral gjate ushtrimit te nje presioni 43 kg te aplikuar ne te dy anet e helmetes per nje periudhe te caktuar nuk ka deformime te pakthyeshme.

-Performanca ndaj temperaturave te uleta nuk peson ndryshime dhe kur eshte ne temperatura -20 deri ne -30 grad celcius.

-Ngjyrat e kasketave te jene te verdha dhe te bardha sipas klerkesave te autoritetit kontraktor. -Te jene te certifikuara CE dhe ne perputhje me standartin EN 397, CE CAT III

Ambalazhimi , marketimi dhe etiketimi

Çdo helmete futet ne qese dhe paketimi i tyre te jete me kuti te medha kartoni ne sasi qe pesha e tyre te mos shkaktoje deformime te kutise

13. Doreza gome izoluese dielektrike , min 40 cm te gjata

Voltazhi operativ : 7500 VAT

Standart: Kategoria e EC : Rreziqe të pakthyeshme, kategoria III

EN 60903-2003 dhe IEC 903-2002 ose ekuivalenti i tyre

Klasi: 1

14. Maska

Maskë e rehatshme në formë kupe. Valvul nxjerrëse për frymëmarrje më të lehtë. Kapëse hunde e rregullueshme për përputhje sa më të mirë. Llastikë mbajtës të ngjitur me ultrasound.Valvul frymëmarrje me performancë të lartë për të reduktuar nxehtësinë dhe për të mundësuar komfort kur përdoret në kushte të ngrohta dhe me lageshtirë.

Hapësira e brendshme e bollshme për të ndihmuar frymëmarrje më të lehtë. Ideale për tu përdorur gjatë gjithë ditës.

Standarti: SSHEN 149 FFP2 (NR D) ose ekuivalent

15. Sapun duarsh i lengshem

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistët e fushës, pjesë e DST.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e mallit dhe lidhen ngushtë me natyrën e kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo specifikim dhe standard të kërkuar.**